V E N D I M
Nr.12, datë 24.1.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR 3O9, DATË 21.6.1993 "PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË ARTISTIKE NË LETËRSI, ARTIN FIGURATIV MUZIKOR, KINEMATOGRAFIK, INTERPRETATIV, PUBLICISTIK, SI DHE KONTRIBUTIN E ANGAZHIMIT TE PERKOHSHEM NE PROJEKTET KULTURORE"

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. N ë vendimin e Këshillit të Ministrave nr.3O9, datë 21.6.1993, në pikën 4, në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" fjala "e fitimit" të zëvendësohet me fjalën "të të ardhurave".

2. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzimin përkatës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.11.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi